



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2573, datë 01.06.2015

Për

Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Sajet sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 01.06.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit Sajet Sh.p.k., kundër masës administrative të dënimit me Gjobë.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;

3. Rregullore e AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 23Prot. datë 19.4.2015, (nr. 610/4 Prot. i AKEP, datë 21.4.2015), “*Reklamim mbi Aktin e Inspektimit të datës 25.3.2015*” të sipërmarrësit Sajet sh.p.k.
2. Urdhri i Inspektimit nr. 610Prot, datë 11.3.2015; Akti i Inspektimit me nr. 610/1/1Prot, datë 25.3.2015; Gjoha nr. 21, datë 25.3.2015, dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj praktike inspektimi;
3. Kontratat e pajtimtarit me nr. 89, për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm, (*vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i sipërmarrësit gjatë inspektimit*);
4. Korrespondenca me postë elektronike e shkëmbyer mes palëve;
5. Relacion shpjegues (*Relacioni*);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I.

Sipërmarrësi Sajet sh.p.k. me shkresën nr. 23Prot, datë 19.4.2015, me objekt “*Reklamim mbi aktin e inspektimit të datës 25.3.2015*” drejtuar Këshillit Drejtues të AKEP, sqaron mbi problemet që kanë dalë gjatë inspektimit të kryer më datë 12.3.2015.

Sajet sh.p.k. shpjegon se është kontaktuar nga AKEP më datë 12.3.2015, dhe vetëm i është kërkuar takim, pa e sqaruar për arsyet e takimit. Kur kanë mbërritur tek vendndodhja e centralit, është informuar në lidhje me inspektimin që po kryhej. Më tej shpjegon përfaqësuesi i Sajet sh.p.k., inspektorët kanë pyetur në lidhje me:

- *Faqen online të kompanisë*
Për të cilën sipërmarrësi shpjegon se, ka qenë e mbyllur për mungesë pagese.
- *Funksionimin e numrave të emergjencës 127, 128 e 129*
Sajet shprehet për këtë se, numrat e emergjencës nuk funksiononin sepse Albtelecom kishte vendosur prefiksin e qytetit.
- *Kontratat e aplikuara me pajtimtarët*
Për këto kontrata, Sajet shpjegon se, aplikon ato të vitit 2000, kur ka filluar aktivitetin.
- *Kontratën me kompaninë nga e cila merret shërbimi internet*
Sajet ka vënë në dispozicion kontratën me Abissnet sh.a.
- *Realizimin e trafikut ndërkombëtar dhe Frekuencat që përdorin*
Sajet ka shpjeguar se, trafikun e kryen me Albtelecom sh.a. dhe frekuencat e përdorura janë ato që ka caktuar AKEP.

Sajet sh.p.k. shpjegon se pas tre ditësh i është kërkuar të paraqitet për të lexuar dhe më pas për t'a firmosur Aktin e inspektimit, të cilin e ka refuzuar, pasi shumë çështje për të cilat ishte mbajtur akti, nuk i kishin kërkuar sqarime.

Sajet shpjegon se, sa më lart parashtrori, nuk i shërben ndreqjes së problemit, të cilat janë shume si teknike dhe ekonomike.

Në përfundim,

Sajet sh.p.k. kërkon nga Këshilli Drejtues i AKEP, që, gjoha e vendosur me nr. 21, datë 25.3.2015 të hiqet.

II.

i. Sa i takon procesit të inspektimit, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes së inspektimit (*Akt Inspektimi nr. 610/1Prot., datë 25.3.2015 dhe Relacioni nr. 610/2Prot., datë 26.3.2015*), vërehet se, me Urdhrin e Inspektimit nr. 610Prot., datë 11.3.2015, Kryetari ka udhëruar kryerjen e inspektimit në sipërmarrësin e komunikimeve elektronike Sajet sh.p.k., me objekt verifikimin e zbatimit të:

- Kushteve të autorizimit të përgjithshëm;
- Rregullores për “Për portabilitetin e numrit“;
- Rregullores për “Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike“;
- Rregullores për “Administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar dhe ndërkombëtar për interkoneksin e rrjeteve“;
- Rregullores për “Dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave“;
- Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve“;
- Konformitetit të pajisjeve dhe aparaturave, sipas Rregullores nr. 25, datë 14.6.2012;
- Rregullores “Për treguesit e cilësisë së shërbimit“;
- Kushteve të përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet që përdoren në këto breza“;
- Rregullores për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve në RSH“;

ii. Në zbatim të urdhrin të lartpërmendur, grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e sipërmarrësit Sajet sh.p.k., dhe i ka dorëzuar kopje të urdhrin, duke i kërkuar krijimin e kushteve për kryerjen e inspektimit konform nenit 12, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”.

Grupi i inspektimit, gjatë kryerjes së inspektimit është shoqëruar nga përfaqësuesi ligjor i Sajet sh.p.k. Në përfundim të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të sipërmarrësit dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sipërmarrësi, grupi i inspektimit ka konstatuar se:

iii. Sipërmarrësi Sajet sh.p.k. sipas Autorizimit Nr. 2012-AP-U264-8-1, ofron:

Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

- Rrjete publike tokësore fikse

Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike:

- Shërbime telefonike / shërbime të linjave me qira / shërbime të tjera (internet)

Sajet sh.p.k., ofron shërbimin telefonik dhe internet, në komunën Dajç dhe Hajmel të rrethit të Shkodrës, duke patur 190 përdorues të telefonisë fikse dhe 30 përdorues të shërbimit internet. Po ashtu, ka kryer regjistrimin e përdoruesve të telefonisë fikse dhe të shërbimit internet.

iv. *Problemet/shkeljet e konstatuara:*

Shërbimet e urgjencës: sipërmarrësi nuk ka të implementuar numrat e shkurtuar të emergjencës: 127, 128 e 129.

Kontrata me pajtimtarët: grupi i inspektimit ka konstatuar se kontrata me pajtimtarët që sipërmarrësi ka aplikuar, nuk është në përputhje me Rregulloren nr. 31, datë 26.12.2013 “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”. Inspektorët kanë marrë në shyrtim kontratën nr. 89, të pajtimtarit z. Loro Gjoki, për shërbimin e telefonisë fikse.

Treguesit e cilësisë së shërbimit: nga verifikimi i inspektorëve, rezultoi se Sajet sh.p.k. nuk ka zbatuar pikën 1, të nenit 11 të Rregullores për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit, për matjen e cilësisë së shërbimit.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të rregullores së lartpërmendur, Sajet sh.p.k. brenda 6 muajve nga përfundimi i kohës së caktuar për fillimin e matjeve të treguesve të cilësisë së shërbimit, nuk ka përgatitur manualin që përfshin dokumentacionin që përcaktohet sipas këtij neni.

Publikimi i informacionit: Sajet i ka deklaruar inspektorëve se, ka kryer publikimin e informacionit për tarifatat dhe kushtet e aksesit të përdorimit të shërbimeve në faqen e internetit, por nga verifikimi në vend, inspektorët konstatuan se, faqja www.sajet.al nuk funksionon.

Të dhënat statistikore/financiare: lidhur me këto të dhëna, inspektorët konstatuan se Sajet sh.p.k. nuk ka përmbushur detyrimet e Rregullores për “Të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Speed test: duke qenë se Sajet sh.p.k. nuk ka faqe interneti, grupi i inspektimit nuk mund t’ua kryente këtë matje të shpejtësisë së internetit tek përdoruesit fundor.

Verifikimi i zbatimit të Rregullores për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në R.Sh.”: për këtë pikë, grupi pas verifikimit ka konstatuar se sipërmarrësi ka deklaruar të dhëna jo plotësisht në përputhje me rregulloren.

- v. ***Në përfundim*** të procesit të kontrollit, grupi i inspektimit duke u bazuar në: verifikim faktik, në provat e dokumentat e marra në dorëzim, shpjegimet dhe konstatimet, arriti në konkluzionin se, sipërmarrësi Sajet sh.p.k., ka kryer kundravajtje administrative, duke mos zbatuar parashikimet e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, konkretisht nenin 99 pika 1, gërma ë, në lidhje me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me pajtimtarin, duke mospasqyruar në kontratat me pajtimtarët kërkesat e ligjit nr. 9918, të ndryshuar dhe rregullores nr. 31, datë 26.12.2013.
- Në këto procedura, duhet të ishte parashikuar në kontratë, e drejta e pajtimtarit për t’ju drejtuar AKEP-it, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me sipërmarrësin, (si një procedurë e thjeshtë e shpejtë e pa kosto për zgjidhjen e mosmarrëveshjes), përpara se t’i drejtohet gjykatës, sipas kërkesave të:
1. Nenin 107, i Ligjit nr. 9918/2008, “për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin nr. 102/20012.
 2. Rregullores nr. 31, datë 26.12.2013, “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike”, pika VIII, nënpika 7, mbi trajtimin e ankesave.
- Referuar edhe nenit 99/5 të ligjit nr. 9918/2008, sipërmarrësit kanë detyrimin e hartimit të kontratës me pajtimtarit mbi bazën e legjislacionit në fuqi, dhe rregullave të nxjerra nga AKEP në zbatim të tij.

Për këtë arsye, grupi i inspektimit, mbështur në nenin 137, pika 5 e paragrafit V, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, vendosi ndëshkimin e sipërmarrësit Sajet sh.p.k., me masën administrative të dënimit me gjobë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) Lekë.

Për këtë pikë, inspektorët i lanë detyrë sipërmarrësit të fillojë pajisjen me kontrata të reja me të gjithë elementët e kërkuar nga ligji nr. 9918, i ndryshuar dhe Rregullorja nr. 31, datë 26.12.2013, brenda datës 15.4.2015.

- vi. Inspektorët, *në lidhje me shkeljet e tjera të konstatuara* më lart, kanë lënë detyrat:
- Të bëjë funksionale menjëherë faqen e internetit të këtij sipërmarrësi me domain: www.sajet.al;
 - Të bëjë publikimin e informacionit për tarifatat në përputhje me Rregulloren “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”;
 - Të zbatojë nenin 11 pikën 1 të “Rregullores për treguesit e cilësisë së shërbimit” për matjen e cilësisë së shërbimit, brenda datës 31.3.2015;
 - Të përgatisë të dhënat e rrjetit të aksesit në përputhje me rregulloren për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike

të komunikimeve elektronike në R.SH.” dhe t’i dërgojë me e-mail, në adresën e personit përgjegjës në AKEP, brenda datës 30.4.2015.

- Të implementojë në central numrat e shërbimeve të ememrgjencës 127, 128 e 129, brenda datës 8.4.2015;
- Të përmbushë detyrimet e rregullores nr. 12, datë 7.12.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare peridodike të sipërmarrësve të rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike”, brenda datës 31.3.2015.

III.

AKEP, pasi shqyrtoi:

- (1) pretendimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga sipërmarrësi, dhe
- (2) aktet në dosjen e inspektimit të hartuara dhe të mbledhura nga Grupi i Inspektimit,
- (3) konstatimet dhe rezultatet e këtij inspektimit, procedurën dhe afatet kohore të paraqitjes së akteve, vlerëson se:

1. Ankimi i paraqitur nga Sajet sh.p.k. më datë 19.4.2015, është protokolluar në AKEP me nr. 610/4 Prot., datë 24.4.2015.
2. Masa administrative e dënimit “Gjobë”, e vendosur nga grupi i inspektimit, me nr. 21, mban datën 25.3.2015, dhe i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 610/3Prot i AKEP, datë 26.3.2015. Bashkëlidhur kësaj të fundit, sipërmarrësit Sajet sh.p.k. i janë dërguar Akti i inspektimit dhe Fleta e Gjobës së lartpërmendur.

Sa më lart shpjeguar, Ankimi Administrativ i sipërmarrësit Sajet sh.p.k., është kryer jashtë afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 136, pika 1, e ligjit nr. 9918, i ndryshuar, dhe Rregullorja nr. 34, datë 23.12.2014 “Për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”,

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe në nenin 144/b, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të mospranojë Ankimin Administrativ të sipërmarrësit Sajet sh.p.k. me nr. 23Prot., datë 19.4.2015, kundër masës administrative “Gjobë” me nr. 21, datë 25.3.2015, për shkak se afati kohor prej 10 ditësh i parashikuar nga ligji për paraqitjen e tij ka përfunduar.
2. Të njoftohet sipërmarrësi Sajet sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

1. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**